

**DREJTUAR: AKM-TIRANE**  
**PER DIJENI: DRM-SHKODER**  
**MALESI E MADHE**

**LENDA: KERKESE PER PJESEMARRJE NE ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B:**

**ID 3.10, PRODHIMI I PRODUKTEVE ABRAZIVE DHE PRODUKTEVE TË TJERA MINERALE JO METALIKE (LINJE PERPUNIM INERTESH)**

**VEPRIMTARITË E KATRAMIT DHE TË BITUMIT ID 7.3 c. VEPRIMTARITE QE NUK PËRFSHIHEN NË PIKAT 7.3.a OSE 7.3.b OSE NË PIKA TË TJERA TË KËSAJ SHTOJCE, QË PËRFSHIJNË NGROHJEN, POR JO DISTILIMIN E KATRANIT OSE BITUMIT NË LIDHJE ME NDONJË VEPRIMTARI PRODHIMI (LINJE PRODHIMI ASFALTO-BETONI)**

**SUBJEKTI : "MALESIA VALTUR" SH.P.K.**

**ADMINISTRATORI: Z. PALOK DODAJ**

**ADRESA : SHKODER, KASTRAT PJETROSHAN,  
RRUGA NACIONALE SHKODER-HANI I HOTIT, KM 5,  
NR PASURIE 2977, ZONA KADASTRALE 2220.**

**MALESI E MADHE 2018**

**Subjekti "MALESIA VALTUR" Sh.p.k. me perfaqesues ligjor Z.PALOK DODAJ merret me aktivitetin; Impiant per Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit.**

**Subjekti "MALESIA VALTUR" Sh.p.k. me perfaqesues ligjor Z.PALOK DODAJ ne Perputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja , ky subjekt duhet te aplikojë per leje mjedisi të tipit B.**

**SUBJEKTI : SUBJEKTI "MALESIA VALTUR" SH.P.K. ME NR. NIPTI J78428713E**

**ADMINISTRATORI: Z. PALOK DODAJ**

Ne afersi te zones ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkolla ,vepra arti,argjinatura,linje eletrike dhe linje uji qe mund te demtohen nga zhvillimi i aktivitetit.

Permiresimi urban i kesaj zone, e cila ka patur zhvillime mjaft te medha e te shpejta , urbanistike dinamike kohet e fundit vazhdon te terheq mjaft interesin e subjekteve private.

Hapsira para nderteses se Impiant per Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit eshte e sistemuar , dekoruar me lule e lulishte duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor shume cilesor, cka dhe ka ndikuar ne permiresimin e pamjes vizuale.

Aktiviteti Impiant per Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit është një ndërtesë me hapësirën e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti. Duhet theksuar që subjekti ka disa vite që e ushtron këto aktivitete në këto ambiente dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipërmarresit që kanë aktivitetet pranë Aktivitetit.

Impiant per Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit.

Teritori i zgjedhur është mjaft i pershtatshëm për funksionimin e këtij aktiviteti duke

paraqitur disa perparesi si:

- Sistem perspektiv te furnizimit me energji elektrike.
- Mundesi per zbatimin korekt te projektit
- Mundesi per ngritje te sistemit te kanalizimeve dhe shkarkimeve.

Pozicioni I Impiant per Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit ka te zgjidhura disa nga problemet qe lidhen me anen funksionale si.

- Largesi te mjaftushme nga vendet e banuara.
- Prane fuqise punetore.

Ne te operojne teknologjia dhe instalimet perkatese, ambjentet e sherbimeve mbeshtetese dhe parkimi.

Teknologjia e Aktivitetit

Impiant per Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit eshte teknologji e standarteve europiane prodhim Italian.

Aktiviteti Impiant per Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit eshte teresisht e mbyllur dhe me kontakte teper minimale.

Ambientet e Punes dhe ato sanitare pastrohen jo me pak se nje here ne dite dhe ne raste te vecanta me shume.

Aktiviteti zhvillohet ka kohë që ekziston dhe nuk ka patur asnje problem me komunitetin dhe nuk ka shkaktuar probleme të ndotjes së mjedisit.

Me këtë raport sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Aktiviteti jone ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Ne Impiant per Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit jane punesuar 8 punonjes

te perhershëm.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i këtij aktiviteti është faktor për zbutjen e papunesisë dhe burim të ardhurash për familjet që jetojnë duke punuar në këtë shoqëri.

Në territorin përreth objektit infrastruktura inxhinjerie është në gjendje të mirë, rrugët janë të shtruara, sipërfaqet e lira janë të gjelbëruara me pemë dekorative, sistemi i kanalizimeve, rrjeti elektrik dhe ujësjellësi janë në gjendje të mirë.

Arsyet për përzgjedhjen e këtij vendi për të kryer aktivitetin Z. PALOK DODAJ janë:

- Aktiviteti Impiant për Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit ndodhet në një vend strategjik për zhvillimin e aktivitetit.
- Aktiviteti Impiant për Fraksionimin e Inerteve dhe Asfalto-betonit ndodhet në një zonë që nuk dëmton Komunitetin.
- është me dalje në rrugë si dhe ekziston infrastruktura e nevojshme: rrugë, energji, ujë, sistem kanalizimesh, etj.

### **Ndikimet në mjedis**

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujërave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujërave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.

- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Niveli i zhurmes nuk i kalon 55-70 dB(A) gjatë punës në këtë Impiant. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ketë çlirime të aromave të ndryshme në ambientet përreth objektit e as në brendësi të tij.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.
- Trafiku rrugor. Gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.
- Projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, naftë dhe gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. nuk do të ndikohen nga aktiviteti i subjektit MALESIA VALTUR.

## **Konkluzione**

Në materialin e mësipërm shihet qarte se ka një ndikim minimal dhe pothuajse i papërfillshëm, por gjithsesi Subjekti "MALESIA VALTUR" Sh.p.k. është e ndërgjegjshme se sado minimal ky ndikim duhet të mirë-menaxhohet dhe të bëhen përpjekje teknike për të bërë këtë ndikim me vlerë zero.

Subjekti "MALESIA VALTUR" Sh.p.k. do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresë çdo sygjerim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti ka bërë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone.

Ne Perputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja , ky subjekt duhet te aplikojë per leje mjedisi të tipit B ne AKM-Tirane.

Adresa e AKM-se, ku publiku mund te dergoje komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo ne forme Elektronike:

Adresa: Rruga "Sami Frasheri" Nr.4, Tirane, - Tel/Fax 04 2 371 237 [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)

KONFORM TE TE GJITHA AKTEVE DHE PROCEDURAVE LIGJORE NE FUQI I DREJTOHEM AKM-TIRANE PER NDJEKEN E PROCEDURES KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B.

ADMINISTRATORI  
PALOK DODAJ

TEL: 0695141396